

dhe ka konstatuar se bëhej fjalë për Ali Racajn. Familjarët e kanë varrosur Aliun në varrezat e Siqevës/Sićevo më 22.02.1998. Në korrikun e vitit 2003, kolegji penal ndërkombëtar i Gjykatës së Qarkut të Pejës/Peç e ka dënuar Dibran Fyllin me shtatë vjet burgim për vrasjen e Ali Racajt.

Burimet: deklarata S.R, FDH-31857; Gjykata e Qarkut Pejë, P. Nr. 232/2002 (Dibran Fylli, Tahir Desku), aktgjykimi, 2.07.2003, FDH-31710; SMIP, *Teroristički...*, III, 909; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.298.6.5, FDH-30909; Gjykata e Qarkut Novi Pazar, K. br. 6393 (Alija Halilović dhe të tjerë), kundërshtim ndaj aktakuzës, FDH-2709; *Teroristi mučili ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.09.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Xhemajl (Bislim) Krasniqi

(6.05.1940, shqiptar nga Klina, murator, tre fëmijë)

Xhemajli ka qenë me origjinë nga fshati Çabiq/Čabić. Disa vjet përpara luftës, ai me bashkëshorten dhe fëmijët kaloi për të jetuar në Klinë/Klina. Në datën **23.04.1998**, ai u nis nga Çabiq/Čabić, ku ishte në vizitë të fafesis, për në Ujmirë/Dobra Voda ku planifikonte të hiqej në tren për Klinë/Klina. Ishte kjo hera e fundit që familjarët e shihnin të gjallë. Trupi i pajetë i Xhemajlit u gjet më 27.04.1998 pranë rrugës Skënderaj/Srbica – Gllgoc/Glogovac, në fshatin Gllobar/Globare [Gllgoc/Glogovac]. Trupi ishte i mbuluar pjesërisht me dheun e gjuajtur mbi të. Mbi të gjendej një letër me fjalë të shkruara në gjuhën shqipe: “nuk është identifikuar”. Familjarët e kanë marrë trupin e Xhemajlit më 30.04.1998 nga morgu i spitalit të Prishtinës/Priština. Po atë ditë, e kanë varrosur në varrezat e fshatit Shupkoc/Šupkovac [Mitrovicë/Kosovska Mitrovica].

Burimet: deklarata R.K, FDH-31856; SMIP, *Teroristički...*, III, 910; KMDLNJ, *Buletini*, num. 7, prill-qershor 1998, 106, FDH-23816; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Teroristi mučili ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.09.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Milan (Ljubiša) Tenić

(25.05.1963, serb nga Petrovci në Mllavë, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Milani ka lindur në Dobrotin, pranë qytetit të Bajina Bashtës. Nga viti 1983, ai punonte në Shërbimin e Punëve të Brendshme të Petrovcit në Mllavë. Në fillim të muajit prill të vitit 1998, ai me një grup policësh nga qyteti i tij u nis për në Kosovë. Në orët e pasdites së datës **24.04.1998**, Milani gjendej në autokolonën policore e cila lëvizte nga Klina për në Skënderaj/Srbica. Ishte i ulur në makinën e parë të autokolonës. Në afërsi të **Reznikut/Resnik**, autokolona policore ka rënë në pritë të forcave të UÇK-së. Milani doli nga vetura dhe, në atë çast, dikush nga fusha përkaj rrugës hapi zjarr mbi të dhe e qëllloi për vdekje. Milanin e kanë varrosur në Petrovac në Mllavë më 26.04.1998.

Burimet: deklarata V.T, FDH-20730; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 69; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 932; D. Radosavljević, *Borci Mlave*, 197.

Nenad (Slobodan) Jaredić

(10.05.1970, serb nga Jashanica/Jošanica, komuna e Klinës/Klina, postier)

Nenadi ka qenë shef i zyrës lokale të postës në fshatin Ujmirë/Dobra Voda. Me familje jetonin në Jashanicë/Jošanica. Në datën **4.05.1998**, Nenadi ka qenë duke i ndarë pensionet në kafenenë e fshatit, në afërsi të stacionit hekurudhor. Nga ora 14:00, në kafene kanë hyrë katër pjesëtarë të UÇK-së, e morën Nenadin dhe e çuan në drejtim të panjohur. Trupi i tij i pajetë u gjet të nesërmen buzë rrugës, në fshatin Arllat/Orlate [Gllgoc/Glogovac]. Ishte i therur në fytyrë dhe me plagët nga plumbat në kokë. E varrosën në fshatin e lindjes më 6.05.1998.

Burimet: deklarata D.Đ, FDH-31214; deklarata V.S, FDH-5591; deklarata M.R, FDH-18928; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; Z. Stijović, *Kosmet...*, 116; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.298.6.5, FDH-30909.

Avdyl (Murat) Gashi

(5.11.1949, shqiptar nga Sverka/Svrhe, komuna